REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 851/20
Datë/Datum. 13.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

---

**PSH.nr.851/20**

PANELI SHQYRTUES,i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042,i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068,dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Blerim Dina –Kryetar ,z. Nuhi Paçarizi – Referues, z. Goran Milenković -Anëtar,duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE: N.T.SH. "M.S.MEDICOM" B.I -Prishtinë, kundër njoftimit mbi Vendimin për dhënien e aktivitetit të prokurorimit Ku është Rekomanduar për Kontratë OE "N.T.P. Dardani X" ,lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Funizim me Aparata të Frymarrjes dhe Bombola te Ajrit" me nr. të prokurimit: 21432700-20-4902-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Agjencia e Menaxhimit Emergjent., më datën 12.11.2020, mori këtë:

## V E N D I M

**I.APROVOHET**, si pjesërisht e bazuar ankesa e Operatorit Ekonomik: N.T.SH. "M.S. MEDICOM" B.I -Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me Aparata te Frymarrjes dhe Bombola te Ajrit" me nr. të prokurimit: 21432700-20-4902-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Agjencia e Menaxhimit Emergjent.

**II.VËRTETOHET,** njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me Aparata te Frymarrjes dhe Bombola te Ajrit" me nr. të prokurimit: 21432700-20-4902-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Agjencia e Menaxhimit Emergjent.

**III.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me

Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

**V.** Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik OE: N.T.SH. "M.S.MEDICOM" B.I –Prishtinë aprovohet si e bazuar, i bëhet Kthimi i depozitës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

**VI.** Obligohet operatori ekonomik ankues që konformë nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE: N.T.SH. "M.S.MEDICOM" B.I –Prishtinë si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 23.10.2020, me nr. 851/20,kundër Njoftim Vendimit mbi dhënien të aktivitetit të prokurimit,lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull"Furnizim me Aparata te Frymarrjes dhe Bombola te Ajrit" me nr. të prokurimit: 21432700-20-4902-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Agjencia e Menaxhimit Emergjent.

- Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet6, 7, 10, 11, dhe 59të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës

Organi Shqyrtues i Prokurimit konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 26.10.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt:04.11.2020,lidhur me pretendimet ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

**<u>Përgjigje në pretendimet Ankimore-</u>**

Pretendimet Ankimore te OE Medicom se është shkelur neni 59 i LPP-se se OE i rekomanduar për kontratë "N.T.P. Dardani X"është i Pa përgjegjshëm. Eksperti shqyrtues mendon se është plotësisht i qëndrueshëm pretendimi sepse, AK i AME-se nuk ka dëshmi se ka bere vlerësim teknik te ofertave por vetëm ne baze te çmimit me te ulte e ka rekomanduar për kontrate dhe te gjithë OE tjerë qe kane ofertuar i ka trajtuar si OE te pasuksesshëm.

Ne baze te nenit 59 te LPP-se AK i AME-se duhet te beje vlerësim te ofertave ne përputhje me specifikimet teknike te Aneksit 1 dhe kritereve te përcaktuar ne Njoftimin për kontrate ka mundur te kërkoj sqarime lidhur me specifikimet teknike dhe dokumentet tjera te pa qarta.
Eksperti shqyrtues duke e u bazuar ne pretendime ankimore te OE Ankues -kam shqyrtuar Aktivitetin e Prokurimit lidhur me ketë tender e konstatoj se AK i AME nuk ka dëshmi se ka bere vlerësim teknik te asnjërit nga OE qe kane ofertuar ne tender qe kjo konsiderohet shkelje e rende e LPP-se pasi te shpallet një tender me vlere 800,000.00 euro e fare te mos beje vlerësime teknike kjo shihet qarte pa përgjegjësin e njesis se kërkesës po edhe te AK tersi . (Ne ketë konstatim bazona ne dokumentet qe janë te ngarkuara ne E-prokurim nuk ka vlerësim teknik)

Eksperti Shqyrtues mendon se edhe pretendimet tjera te OE Ankues Medicom janë te qëndrueshme sepse AK i AME-se duhet te beje vlerësim te ofertave ne përputhje me RRUOPP dhe ne përputhje me LPP_ne e jo te mundohet te realizoj një projekt prej 800,000.00 euro pa kurrfarë vlerësimi teknik te ofertave ketë dëshmohet se as ne raportin e vlerësimit ne hapin 8 te raportit te vlerësimit (e-prokurim) qe kërkohet te jepet një vlerësim teknik -konstatim te ofertave për secilin OE nuk ka kurfar konstatimi , shënimi -vlerësimi.

Duke u bazuar ne pretendimet Ankimore dhe ne analizimin e Aktivitetit te Prokurimit pretendimet e OE Ankues lidhur me vlerësimin teknik është bazuar vetëm ne mostra dhe vetëm te një pjese e dokumentacionit te ofertave e pretendimet nuk munde te merren krejtësisht te bazuara por eksperti mendon se AK duhet te vlerësoj se pari ofertat administrativisht e tani teknikisht e pas vlerësimit administrativisht dhe teknikisht te rekomandoj OE me çmim me te ulet.

Ne baze te Ligjit eksperti mendon se është përgjegjësi e AK – njësis se kërkesës qe te beje vlerësimin e te gjitha ofertave ne përputhje me Aneksin 1 te Dosjes se tenderit dhe te nxjerr një përfundim se cila kompani i ka plotësuar kërkesat teknik mandatori me se miri e atëherë te beje një krahasim te ofertave qe është me e përshtatshme edhe për nga çmimi e te rekomandoj për kontrate, e jo te mundohet ta heqë përgjegjësin nga vetja lidhur me ketë projekt.

Ne baze te konstatimeve te cekura me larte se pretendimet ankimore janë te bazuar dhe tenderi duhet te kthehet ne piken zero te vlerësimit qe njësia e kërkesës dhe njësia e prokurimit te bëjnë një vlerësim teknik te ofertave duke u bazuar ne Aneksin 1 te dosjes se tenderit dhe ne sqarimet qe janë bere lidhur me ketë Aktivitet te prokurimit, ne përputhje me nenin 59 dhe me nenin 72 te LPP_se te

sigurojë sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve eksperti mendon se çdo rekomandim tjetër nga eksperti por edhe nga paneli shqyrtues do te biem ne lajthitje te njësisë se kërkesës se AME-se .

Gjithashtu ne kërkesën për Rishqyrtim qe kam analizuar unë si ekspert AK i AME-se nuk ka rishqyrtuar pretendimet ankimore te OE ankues, ku ka pas mundësi AK ti korrigjoj lëshimet qe janë bere gjate fazës se vlerësimit Ne konstatimin përfundimtar eksperti shqyrtues mendon se lënda "Furnizim me Aparata te Frymarrjes dhe Bombola te Ajrit" me nr. të prokurimit: 21432700-20-4902-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues –Agjencia e Menaxhimit Emergjent duhet te kthehet ne rivlerësim ne piken zero te vlerësimit te ofertave. Ndërsa kërkoj nga Paneli Shqyrtues qe Ankesën te merret e bazuar e te kërkoj nga AK-ja qe te anulohet njoftim vendimi mbi dhënien te datës 08.10.2020 e tenderi te kthehet ne Rivlerësim pasi nuk ka vlerësim teknik te ofertave nga njësia e kërkesës.

## 8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti Shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE "N.T.SH. M.S.MEDIKOM"B.I, për Tenderi me titull;"Furnizim me Aparata te Frymarrjes dhe Bombola te Ajrit", te anulohet njoftim vendimi mbi dhënien e lënda te kthehet ne Rivlerësim dhe ankesa te merret si e bazuar.

Organi Shqyrtues i Prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 04.11.2020 me raportin e ekspertizës

Autoriteti Kontraktues, me datën 05.11.2020 me anë të parashtresës, e ka njoftuar OSHP-në Ju njoftojmë se AK, nuk Pajtohet me konstatimin e ekspertit shqyrtuese ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datën 05.11.2020 me anë të parashtresës, e ka njoftuar OSHP-në Me ane te këtij emali konfirmojmë pranimin dhe ne te njëjtën kohe ju njoftojmë ne pajtohemi me mendimin e ekspertit

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 12.11.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie

të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE: N.T.SH. "M.S.MEDICOM" B.I –Prishtinë ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron si me poshtë:

Lidhur me pretendimin e OE ankues se oferta e OE nuk i përmbushë kriteret esenciale lidhur me sistemin e mbajtjes, cilindrit te ajrit dhe maskës, të cilat janë përcaktuar nga AK, këto kritere ndër të tjera përfshijnë që rripat e shpatullave të jenë të punuar nga materiali aramid, aprovimi EN 14593, standardi MED 2014/90/EU, shënimet dhe dëshmitë lidhur me rezistencën e rripave ndaj shpimit, kimikateve, gërryerjes, apo për mekanizimin paralajmërues të matësit të presionit ose manometrit, si dhe që maska apo trupi i maskës të jetë më dy shtresa të dyfishta izoluese – si kriteri më i rëndësishëm në këtë specifikacion, e të cilin OE Dardanix nuk e plotëson pasi që ka ofruar maskë me vetëm një shtresë izolimi nuk ofron siguri të mjaftueshme për lëvizje të kokës, Paneli Shqyrtues konstaton se:

*Pretendimet e OE ankues te lartshënuara nuk qëndrojnë, pasi që OE i rekomanduar për këtë kontratë ka ofruar katalogun të detajuar me të cilën i konfirmon dhe plotëson të gjitha pikat e kërkuara nga AK në Aneksin 1. Gjithashtu OE i rekomanduar ka prezantuar deklaratën e konformitetit e cila konfirmon se pajisjet e ofruara nga Prodhuesi Interspiro janë sipas standardit MED 2014/90/EU.*

Lidhur me pretendimin e OE ankues se, OE në fjalë duhet të eliminohet nga aktiviteti i prokurimit pasi që i njëjti nuk i përmbushë kriteret esenciale që kërkohen për këtë aktivitet të prokurimit si dhe për faktin se ka ofertuar me çmim tejet të lartë, Paneli Shqyrtues konstaton se:

*Ky pretendim i OE ankues nuk qëndron pasi që oferta e dhënë e OE fitues i plotëson të gjitha kriteret e kërkuara ne FDT dhe njëherit* është *oferta më e lire ne këtë aktivitet të prokurimit.*

<u>Më konkretisht, në tabelën në vijim në shtyllën e djathte Paneli Shqyrtues, gjithnjë duke u bazuar në dokumentacionin e OE të rekomanduar per kontratë, ka nxjerrë në pah konstatimet lidhur me pretendimet e OE ankues në të cilat janë paraqitur Specifikat teknike të kërkuara nga AK (në anën e majtë) dhe ofertën e dorëzuar nga OE N.T.P. "DardaniX" (në anën e djathtë)</u>

| NR. | SPECIFIKIMI TEKNIK I AUTORITETIT KONTRAKTUES | SPECIFIKIMI TEKNIK I OPERATORIT EKONOMIK | PRETENDIMET E OE ANKUES | **KONSTATIMET E PANELIT SHQYRTUES** |
|---|---|---|---|---|
| **1. SISTEMI I** | | **Interspo** | **Pasojat që rrjedhin nga** | **Konstatimet e Panelit** |

| MBAJTJES | | Spiromatic 90 U | dallimet në mes të produkteve të kërkuara dhe atyre të ofruar | Shqyrtues |
|---|---|---|---|---|
| 1.1 | Rripat e shpatullave duhet të janë rezistente ndaj gërryerjes dhe shpimit, të jenë rezistent ndaj kimikateve dhe të jenë rezistent ndaj zjarrit | Duke u bazuar në broshurat e prodhuesit, të paraqitura në web-faqe, rrypat nuk janë rezistent ndaj gërryerjes, shpimit dhe materieve kimike apo acideve | Në rast se rripat nuk sigurojnë rezistencën e kërkuar, të njëjtit mund të këputen lehtë apo të shkatërrohen ose pëlcasin nga acidi, dhe në këtë mënyrë rrezikojnë jetën e personave që i bartin këto pajisje. | Ky pretendim **nuk qëndron**, pasi në **dokumentin 06) Katalogu – faqe 1** dhe **faqe 4** të dorëzuar nga EO i rekomanduar për kontratë shihet qartë se rripat e shpatullave janë rezistent ndaj gërryerjes dhe shpimit, ndaj kemikateve dhe ndaj zjarrit. |
| 1.2 | Matësi i presionit ose Manometri duhet të jetë i strukturës luminiscente për t'i lejuar përdoruesit të monitorojnë presionin në hapësirat e errëta. -Matësi i presioni të ketë një mekanizëm paralajmërimi në rast se presioni i brendshëm i cilindrit bie në 50 ± 5 bar. | Nuk posedon shënime në katalogun e prodhuesit që matësi i presionit është luminiscent. Nuk posedon shënime në katalogun e prodhuesit në çfarë presioni paralajmëron në rast se presioni i brendshëm i cilindrit bie në 50 ± 5 bar. | Në rast se matësi i presionit nuk është luminiscent, përdoruesve do t'iu pamundësohet monitorimi i presionit në hapësira të errëta. Në rast se matësi i presionit nuk paralajmëron kur presioni bie në 50 bar apo më pak, atëherë përdoruesi nuk mund të ketë kohë të mjaftueshme për evakuim, dhe kjo dukuri mund të shkaktojë vdekjen e zjarrfikësit | Ky pretendim **nuk qëndron**, pasi në **dokumentin 06) Katalogu – faqe 1** të dorëzuar nga EO i rekomanduar për kontratë shihet qartë se manometri është i strukturës luminiscente. Tutje konfirmohet se matësi i presionit ka një mekanizëm paralajmrimi në rast se presioni i brendshem i cilindrit bie në 50 ± 5 bar. |
| 1.3 | Presioni nominal i fazës së parë: 7.5 bar | Nuk ka shënime | Presioni nominal është të jetë i rëndësishëm që reduktimi nga 300 në ~ afërsisht 1 bar të jetë i përshkallëzuar. Në rast se deshton reduktuesi i presionit të lartë, mushkria automatike të jetë preventivë. | Ky pretendim **nuk qëndron**, pasi në **dokumentin 06) Katalogu – faqe 1** të dorëzuar nga EO i rekomanduar për kontratë shihet qartë se presioni nominal i fazes së parë **është 7.5 bar** |
| 1.4 | Rrjedhja e mushkrisë automatike: 400 l/min | Nuk ka shënime për rrjedhjen e mushkërisë | Nëse rrjedhja është më e ulët se sa është kërkuar nga AK, përdoruesi mund të ketë vështirësi në frymëmarrje | Ky pretendim **nuk qëndron**, pasi në **dokumentin 06) Katalogu – faqe 1** të dorezuar nga EO i rekomanduar për kontratë shihet qartë se rrjedhja e mushkrisë automatike **është 400 l/min** |
| 1.5 | Zhurma e filikaqës, | Nuk ka shënime | Nëse zhurma është më e | Ky pretendim **nuk** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | minimum:<br>90 decibel -Dba | | ulët, përdoruesi rrezikohet të mbetet pa ajër rezervë për vetë-evakuim dhe mund t'i kushtojë me jetë | **qëndron**, pasi në **dokumentin 06) Katalogu – faqe 1** të dorëzuar nga EO i rekomanduar për kontratë shihet qartë se zhurma e filikaqës **është 90 decibel -Dba** |
| 1.6 | EN 136:1998<br>EN 14693<br>(MED) 2014/90/EU | Nuk posedon aprovimin EN 136 (1998)<br>Nuk posedon aprovimin EN 14593<br>Nuk dihet cilin MED standard posedon | Testet laboratorike dhe praktike të performancës janë përfshirë në vlersimet e përputhshmërisë së këtyre kërkesave. Aprovimi EN 136 (1998) specifikon kërkesat minimale të maskës. Në rast se maska nuk posedon aprovimin EN 136, atëherë maska nuk mund të përdoret si pajisje mbrojtëse profesionale.<br>Aprovimi EN 14593 specifikon kërkesat minimale për pajisjet e frymëmarrjes. Do të thotë se kjo pajisje as minimalisht nuk përmbushë standardet e kërkuara për siguri në punë. Ky standard e rrit koston e produktit, dhe për këtë arsye pajisja ka qenë më çmim më të ulët. Mungesa e dëshmive për standardin MED nënkupton se produkti i ofertuar nuk është në përputhje me direktivën 2014/90/EU të Parlamentit dhe Këshillit Europian. Të gjitha këto kërkesa e rrisin shumë koston e produktit, dhe gjithashtu kanë ndikim në sigurinë dhe jetën e zjarrfiksëve. | Ky pretendim **nuk qëndron**, pasi në **dokumentin 06) Katalogu – faqe 1** të dorëzuar nga EO i rekomanduar për kontratë shihet qartë se prodhuesi Interspiro posedon aprovimin EN 136 për kërkesat minimale të maskës. Gjithashtu, kërkesa për aprovimin EN 14593 me sqarime shtese nga AK të dates 15.09.2020 është sqaruar se nuk është obligative që ta këtë standard, megjithatë në **dokumentin 06) Katalogu – faqe 1** të dorëzuar nga EO i rekomanduar për kontratë konfirmohet se edhe këtë aprovim e posedon. Gjithashtu sa i përket standardit MED 2014/90/EU EO i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar **dokumentin 06) Katalogu – faqe 1** ku shihet qartë se prodhuesi Interspiro posedon aprovimin MED 2014/90/EU. Gjithashtu EO i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar edhe **dokumentin 05) ISO Certifikata dhe EC deklarata – faqe 4** ku shihet qartë se prodhuesi Interspiro |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **posedon aprovimin** e kërkuar nga AK. |
| **2. CILINDI I AJRIT** | | **Composite Technical System 6.8L** | **Pasojat që rrjedhin nga dallimet në mes të produkteve të kërkuara dhe atyre të ofruar** | **Konstatimet e Panelit Shqyrtues** |
| 2.1 | Duhet të jetë i pajisur me valvulë sigurie të rrjedhës së tepërt<br>Të jetë rezistent ndaj goditjeve, substancave kimike dhe i lehtë për tu pastruar | Nuk posedon shënime që valvulë sigurie të rrjedhës së tepërt.<br>Nuk posedon shënime që është rezistente ndaj goditjeve dhe substancave kimike | Mungesa e valvulës së sigurisë të rrjedhës së tepërt rrezikon jeten e përdoruesit dhe personave afër tij, si dhe ulë koston e bombolës.<br>Mos rezistenca ndaj goditjeve dhe substancave kimike ndikon që cilindri të pëlcasë nga acidi gjë që mund të shkaktojë vdekjen e personave përreth. Po ashtu, në mungesë të kësaj mbrojtje, cilindri ka kosto më të ulët | Ky pretendim **nuk qëndron**, pasi në **dokumentin 06) Katalogu – faqe 1** të dorezuar nga EO i rekomanduar për kontratë shihet qartë se pajisja e ka valvulën e sigurisë të rrjedhjës së tepert dhe gjithashtu se është rezistente ndaj goditjeve, substancave kimike dhe e lehtë për tu pastruar |
| 2.2 | Kohëzgjatja e punës minimumË 45-60 minuta | Nuk posedon shënime në adresën zyrtare të internetit të prodhuesit | | Ky pretendim **nuk qëndron**, pasi në **dokumentin 06) Katalogu – faqe 1** të dorëzuar nga EO i rekomanduar për kontratë shihet qartë se kohëzgjatja e punës **është 45-60 minuta** |
| **3. MASKA** | | **Interspiro S-H Ambient air hatch Mask** | **Pasojat që rrjedhin nga dallimet në mes të produkteve të kërkuara dhe atyre të ofruar** | **Konstatimet e Panelit Shqyrtues** |
| 3.1 | Masa e maskës duhet të përbëhet nga dy shtresa izolimi të dyfishtë për të siguruar përshtatje të sigurt për të gjitha format e fytyrës | Masa apo korniza e maskës nuk posedon dy shtresa izolimi të dyfishtë, por, posedon vetëm një shtresë | Maska me vetëm një shtresë izolimi nuk ofron siguri të mjaftueshme për lëvizjen e kokës.<br>Gjithashtu nuk ofron siguri për zjarrfikës në hapësira të mbyllura | Ky pretendim **nuk qëndron**, pasi në **dokumentin 06) Katalogu – faqe 2** të dorëzuar nga EO i rekomanduar për kontratë shihet qartë se maska përbëhet nga dy shtresa izolimi te dyfishtë për të siguruar përshtatje të sigurt për të gjitha format e fytyrës |
| 3.3 | Materiali i maskës duhet të bëhet nga silikoni hypoallergenic | Nuk ka dëshmi që maska është e bërë nga silikoni hypoallergenic | Në rast se maska nuk është e punuar nga silikoni hypoallergenic (anti alergjik) apo nga | Ky pretendim **nuk qëndron** pasi në **dokumentin 06) Katalogu – faqe 2 dhe** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | (antilergjik), përzier EPDM (testuar dermatologjikisht), çamçakëz apo gomë natyrale që ofron përshtatje të rehatshme dhe është i disponueshëm në tri madhësi S, M dhe L. Full Face maskë | (anti alergjik) Nuk ka dëshmi qe maska është e bërë nga goma natyrale (testuar dermatologjikisht) | goma natyrale (e testuar dermatologjikisht), ajo nuk mund të përdoret nga të gjithë personat. Po ashtu, gjatë përdorimit, maska shkakton iritimin e lëkurës së fytyrës si dhe djersitje, ku lëkura kontaminohet nga jashtë dhe kjo mund t'i shkaktojë sëmundje kancerogjene zjarrfikësit | **faqe 7** të dorëzuar nga ana e EO i rekomanduar për kontratë shihet qartë se maska e ofruar është nga goma natyrale gjë që i plotëson kushtet dhe kriteret e kërkuara nga AK. Me dosje të tenderit dhe sqarimet shtesë të datë 15.09.2020 është kërkuar që testi dermatolog të dorëzohet vetëm në rastin kur materiali i maskës është EPDM. |
| 3.4 | Sistemi i lidhjes me aparatet e frymëmarrjes P | Connection: M16 to breathing valve | Mungesa e lidhjes së sigurt P tregon se ofertuesi ka ofruar pajisje të sigurisë së ulët, i cili nuk posedon sistem të dyfishtë lidhës, ky faktor ndikon në sigurinë e jetës. Për ketë arsye dhe detaje të tjera që mungojnë në broshurën e prodhuesit, OE ka ofertuar pajisjen me çmim më të lirë | Ky pretendim **nuk qëndron** pasi në **dokumentin 06) Katalogu – faqe 2 dhe faqe 6** të dorëzuar nga ana e EO i rekomanduar për kontratë shihet se maska e ofruar **posedon lidhjen P**. |

Tutje Paneli Shqyrtues konstaton se EO i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar të gjitha dokumentet e nevojshme që janë kërkuar në dosjen e tenderit si: CE Certifikata konformitetit, ISO Certifikata dhe autorizimet, dhe ato janë të evidentuara në tenderin e OE të rekomanduar për kontratë nën dokumentet me emërtimet: **dokumentin 03) Autorizimi nga Prodhuesi dhe 05) ISO Certifikata dhe EC deklarata.**

Gjithashtu, pas analizës së procedurës për këtë aktivitet të prokurimit, Paneli Shqyrtues konstaton se Autoriteti Kontraktues ka aprovuar të gjitha kërkesat për sqarime shtese nga Operatorë Ekonomik të ndryshëm, të publikuar në E-prokurimi me datë 15.09.2020, dhe ka larguar edhe disa kritere vetëm e vetëm qe të mundësonte Operatoret Ekonomik të ofertonin me sa më shumë prodhues te ndryshëm.

Autoriteti Kontraktues Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave në zbatim të LPP-së në përgjithësi dhe të Neneve 28 dhe 7 të LPP-së, dhe me dëshirën që sa më shumë oferta me prodhime të prodhuesve botëror, siç citon vet OE ankues Medicom si, Drager, Honeywell, Scott, MSA dhe Interspiro, të dorëzohen në këtë aktivitet të prokurimit, përmes vendimit të datë 18.09.2020,

inkurajon që të gjithë OE të interesuar të dorëzojnë ofertat e tyre duke u siguruar që ofertat e tyre do të vlerësohen dhe se vlerësimi do të bëhet në përputhje me të gjitha dispozitat e LPP-së.

Paneli Shqyrtues konstaton se Autoriteti Kontraktues ka sqaruar në përpikëri të gjitha pretendimet e ngritura në kërkesën për rishqyrtim te datës 14.10.2020, duke e nxjerrë një vendim meritor mbi refuzimin si te pabazuar te kërkesës për ri-shqyrtim e OE "N.T.SH. M.S. Medicom B.I." lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Aparate te Frymëmarrjes dhe Bombola të Ajrit" me numër të prokurimit 21432700-20-4902-1-1-1.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, ndërsa autoriteti kontraktues në këtë rast ka vepruar konform këtij neni. Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka marr parasysh dhe ka vepruar duke pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Paneli Shqyrtues

Z.Blerim DINA

**Vendimi t'i dorëzohet:**

1x1 AK–Agjencia e Menaxhimit Emergjent.

1x1 OE ankues–OE: N.T.SH. "M.S.MEDICOM" B.I-Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.